



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:109232

Datë: 18.03.2024

Numri i dokumentit: 05461858

C.nr.1183/20

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Edije Sezairi, me bashkëpunëtoresh profesionale K.R. në çështjen juridiko kontestimore të paditëses Kompania Kosovare për Distribuum dhe Furnizim me Energji Elektrike KEDS me seli në Prishtinë Zyra Ligjore në Prizren, të cilin me autorizim e përfaqëson V.C. nga Prizreni, zyrtar ligjor pranë të njëjtit, kundër të paditurit R.Sh. nga Prizreni, për shkak të kompensimit të demit material, vlera e kontestit 379.21 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datë 27.02.2024 mori, ndërsa me datë 12.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses Kompania Kosovare për Distribuum dhe Furnizim me Energji Elektrike KEDS me seli në Prishtinë.
- II. DETYROHET** i padituri R.Sh. nga Prizreni që në emër të kompensimit të demit material të shkaktuar për shkak të shfrytëzimit të pa autorizuar të energjisë elektrike, t'ia paguajë paditëses shumën prej **379.21 €**, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 07.09.2020 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- III. DETYROHET** e paditura, që paditësit, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 20 euro, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve

Paditësja Kompania Kosovare për Distribuum dhe Furnizim me Energji Elektrike-KEDS me seli në Prishtinë Zyra Ligjore në Prizren, përmes të autorizuarve të saj pranë kësaj gjykate me datë 07.09.2020, ka parashtruar padi për kompensim demit material kundër të paditurit R.Sh. nga Prizreni, duke theksuar se sipas aktgjykimit penal të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.1561/2019 të datës 09.11.2020 i padituri është shpallur fajtor për shkak të kryerjes së veprës penale vjedhje nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së, ku me qëllim që t'i sjell vetës pasuri të kundërligjshme ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar, ashtu që ka bërë lidhje direkte jashtë njehsorit elektrik i cili është i shkyçur nga distanca ashtu që

energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, me këtë veprim i padituri të dëmtuarës, këtu paditëses i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 379.21 €, dhe meqenëse i padituri nuk ia bërë pagesën e dëmit të shkaktuar paditëses, i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta aprovoj si të bazuar dhe ta detyrojë të paditurin ta paguaj detyrimin.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 27.02.2024 përfaqësuesi i autorizuar i paditëses V.C. ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat e administruara gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor ka rezultuar se i padituri i ka shkaktuar dëm KEDS në shumën prej 379.21 euro, ku bazë për këtë është aktgjykimi penal P.nr.1561/19 të datës 09.11.2020 si dhe fatura DPZ90PP14697 e datës 25.09.2019, e cila është llogaritur komfor procedurës për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike. Gjithashtu ka shtuar se marrë parasysh faktin se i padituri pavarësisht pranimit të rregullt të ftesës dhe padisë për përgjigje, nuk është përgjigjur në padi ka bazë të mjaftueshme për të marrë aktgjykim për shkak të mungesës. Mbi këto baza i ka propozuar gjykatës që provave të administruara në shqyrtim gjyqësor të ia falë besimin dhe ta miratojë në tërësi të bazuar kërkesëpadinë e paditësit si dhe i ka kërkuar shpenzimet procedurale dhe atë për taksën gjyqësore për padi ka shumën prej 20€.

Gjykata shqyrtimin kryesor e ka mbajtur në mungesë të palës së paditur e cila është ftuar në mënyrë të rregullt konform nenit 423.4 të LPK-së.

Gjendja faktike e vërtetuar

Me qëllim të vlerësimit dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar provat si në vijim: Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.1561/2019 të datës 09.11.2020; kalkulimin e rikthimit të humbjeve me numrin 268889 të datës 25.09.2019; faturën me numër DPZHP1914697 të datës 25.09.2019; procesverbali me numër 2286070 të përpiluar nga paditësi me datë 23.09.2019; transaksionet e konsumatorit me shifrën DPZ15304 në emër të të paditurit si dhe janë shikuar 5 (pesë) fotografi.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palës ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 7 dhe nenit 8 të Ligjit Nr. 06/L-003 për Procedurën Kontestimore, tani e tutje referuar si “LPK”, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është **në tërësi e bazuar**, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga leximi i aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.1561/2019 të datës 09.11.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se i padituri është shpallur fajtor për shkak të kryerjes së veprës penale vjedhje nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së, ku i akuzuari këtu i padituri vullnetarisht e ka pranuar fajësinë se ka kryer këtë veprë penale, përkatësisht ka shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar energjinë elektrike dhe për këtë i është shqiptuar dënim me kusht, ndërsa e dëmtuara këtu paditësja Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike-KEDS me seli në Prishtinë Zyra Ligjore në Prizren për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko- civil.

Nga leximi i kalkulimit të rikthimit të humbjeve me numër 268889 të datës 25.09.2019 gjykata vërtetoi faktin se me energjinë e shpenzuar me anë të anashkalimit të matjes nga i padituri,

paditëses i është shkaktuar dëmi në vlerë prej 379.21 euro, e cila faturë përmban llogarinë një mujore.

Nga leximi i faturës DPZHP1914697 të datës 25.09.2019, e lëshuar nga paditësja, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja në emër të rikthimit të humbjeve të paditurit i ka faturuar detyrimin prej 379.21 €, për periudhën kohore prej 1 muaj, e që ndërlidhet konkretisht me periudhën kohore kur i padituri ka shkaktuar veprën penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së, e cila vlerë është e njëjtë si në dispozitiv të aktgjykimit.

Nga leximi i procesverbalit numër 2286070 të datës 23.09.2019, gjykata vërtetoi faktin se me këtë datë, gjatë kontrolles tek i padituri është konstatuar se njehsori ka qenë i shkyçur nga distanca dhe është bërë lidhja direkte para njehsorit, me ç'rast energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar dhe nuk është faturuar.

Nga leximi i transaksionit DPZ-15304 të datës 01.02.2024, gjykata ka vërtetuar faktin se edhe në këtë transaksion është e përfshirë kërkesa për rikthimin e humbjeve e 25.09.2019, në lartësi prej 379.21 euro, ndërsa nga shikimi i fotografive në shkrësat e lëndës gjykata vërtetoi faktin se janë dëmtuar kabllo dhe janë shkyçur nga njehsori elektrik me numër 32596662, duke penguar regjistrimin e energjisë së shpenzuar.

Baza ligjore

Me nenin 136 par. 1. të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është paraparë se: *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Në bazë të kësaj dispozite pala përgjigjet për dëmin e shkaktuar me dashje dhe nga pa kujdesia. Në nenin 140 të po këtij ligji parashihet se: *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”*, e në çështjen kontestuese i padituri nuk i ka ofruar gjykatës prova që do të provonin se dëmi ndaj paditëses është shkaktuar pa fajin e tij. Gjithashtu me nenin 14 të LPK-së është paraparë se: *“Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryesit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilën i pandehuri është shpallur fajtor”*, e që në çështjen konkrete ekziston aktgjykim i formës së prerë që ka shpallur fajtor të paditurin, i cili përmes veprës penale i ka shkaktuar dëm material paditëses.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Pas analizimit dhe vlerësimit të gjendjes faktike të cilën e kemi cekur më lartë, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar në ligj dhe fakte. Gjykata ka vërtetuar se i padituri është përgjegjës për kompensimin e dëmit material këtu paditëses, konform përgjegjësisë në bazë të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) të cekur si më lartë, pasi që i njëjti i ka shkaktuar dëmin material paditëses, duke e shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të pa autorizuar, fakt ky i cili është vërtetuar nga provat e proceduara në këtë çështje kontestimore.

Se i padituri është përgjegjës për kompensimin e dëmit këtu paditësit gjykata e ka vërtetuar përmes Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, me numër P.nr.1564/2019 të datës 09.11.2020, përmes të cilit i padituri është shpallur fajtor për veprën penale vjedhja e shërbimeve, dhe se i njëjti në mënyrë vullnetare e ka pranuar fajësinë, pra në kuptim të nenit 14 të LPK-së, baza juridike e kërkesëpadisë është vërtetuar përmes aktgjykimit të shënuar si më

lartë, ndërsa shuma e dëmit shkaktuar nga ana e paditësit është vërtetuar nga fatura e kalkulimit të rikthimit të humbjeve me numrin 268889 të datës 25.09.2019, nga fatura me numër DPZHP1914697 të datës 25.09.2019 nga procesverbali me numër 2286070 të përpiluar nga paditësi me datë 23.09.2019 si dhe nga transaksionet e konsumatorit me shifrën DPZ15304 në emër të të paditurit, gjykata ua fali besimin dhe vërtetoi faktin se pala e paditur, i ka borxh në lartësinë prej 379.21 euro paditëses, në emër të dëmit material.

Me nenin 136 par. 1. të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është paraparë se *“Kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”*. Në bazë të këtij principi pala përgjigjet për dëmin e shkaktuar me dashje dhe nga pa kujdesia. Në nenin 140 të po këtij ligji parashihet *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”*. Në rastin i padituri nuk ka paraqitur përgjigje në padi dhe e as në shqyrtime gjyqësore nuk ka marrë pjesë që të njëjtën ta kundërshtonte dhe nuk i ka ofruar prova gjykatës që do të provonin se dëmi ndaj paditësit është shkaktuar pa fajin e tij, ndërsa me nenin 245 të po këtij ligji, është paraparë se *“kreditori në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbushë me ndërgjegje krejtësisht sikundër”*. Gjithashtu bazuar në nenin 14 të LPK-së në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryesit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilën i pandehuri është shpallur fajtor.

Kamatëvonesa

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (07.09.2020) , bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse

Shpenzimet procedurale

Vendimi për detyrimin e të paditurit për pagimin e shpenzimeve gjyqësore është marrë konform nenit 452.1 të LPK-së, ku gjykata e obligoi palën e paditur të paguajë shpenzimet procedurale këtu paditësit dhe atë për taksën gjyqësore në shumën prej 20 euro.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1183/20 më datë 27.02.2024

Gjyqtarja
Edije Sezairi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2020:109232
Datë: 18.03.2024
Numri i dokumentit: 05461858